330-331-332/19
341
26.08.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 330 / 19
331 / 19
332 / 19
341 / 19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatoret ekonomik: OE "Infosoft Systems"- Prishtinë, OE "NOVUS" – Prishtinë, OE "PBC" – Prishtinë, dhe OE "BOTEK" – Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit te prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje te TI – Ri-Tender" me nr. të prokurimit: 2016-18-3785-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP, më datën: 26.08. 2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, si pjesërisht te bazuara ankesa e operatorit ekonomik: "Infosoft Systems", ankesa e OE ankesa e "NOVUS", ankesa e OE "PBC" si dhe ankesa e OE "BOTEK", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te TI – Ri- Tender"me nr. të prokurimit: 2016-18-3785-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP.

II. **ANULOHET**, vendimi i AK-Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me pajisje te TI – Ri- Tender"me nr. të prokurimit: 2016-18-3785-1-1-1, dhe lënda kthehet në **ri-vlerësim**.

OBLIGOHET, autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave të kërkoj një mendim profesional nga institucionet kompetente lidhur me pretendimet e tyre për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatoreve ekonomik ankues "InfosoftSystems", OE "NOVUS" , OE -"PBC" si dhe OE "BOTEK", aprovohen si te bazuara, ankuesve i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 09.08.2018
Data e planifikimit hapje te ofertave: 06.09.2018.
Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit me dt. 05.06.2019

Kundër njoftimit për anulim, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit operatoret ekonomik "InfosoftSystems", OE -"NOVUS", OE "PBC", OE "BOTEK", kanë bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Operatori ekonomik OE "Botek" ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit me dt. 07.06.2019.

Operatori ekonomik OE "NOVUS" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit me dt. 10.06.2019.

Operatori ekonomik OE "IfosoftSystem" SH.P.K.ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit me dt. 10.06.2019.

Operatori ekonomik OE "PBC" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit me dt. 10.06.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 14.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE:"InfosoftSystems",OE -"NOVUS" ,OE -"PBC",OE- "BOTEK",si të pa bazuar.

Me datën: 21. 06.2019 OE "Infososft Systems shpk", ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te TI-se – ri Tender" me nr. të prokurimit: 2016-18-3785-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AQP, duke pretenduar në shkelje te këtyre dispozitave te LPP-së:

Shkelje e nenit 28të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Shkelje e nenit 59,të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Shkelje e nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Me datën: 21. 06. 2019 OE "NOVUS" shpk, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te TI-se – ri Tender", LOT 1me nr. të prokurimit: 2016-18-3785-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AQP, duke pretenduar në shkelje te këtyre dispozitave te LPP-së:

- Shkelje e nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 59, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Me datën: 21. 06. 2019 OE "PBC" shpk, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te TI-se – ri Tender" me nr. të prokurimit: 2016-18-3785-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AQP, duke pretenduar në shkelje te këtyre dispozitave te LPP-së:

- Shkelje e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 59, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Me datën: 24. 06. 2019 OE "BOTEK" shpk, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te TI-së – ri Tender" me nr. të prokurimit: 2016-18-3785-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AQP , duke pretenduar në shkelje te këtyre dispozitave të LPP-së:

- Shkelje e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

- Shkelje e nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Shkelje e nenit 59, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28. 06. 2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 03.07.2019, lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues "Infosoft Systems", OE- "NOVUS", OE -"PBC", OE- "BOTEK", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te TI – ri Tender" me nr. të prokurimit: 2016-18-3785-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP në finalizim te analizimit dhe shqyrtimit te këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimore të OE ankues "Infosoft Systems" shpk –Prishtinë

Pretendimi: "Ankesa dorëzohet kundër vendimit për Anulim te aktivitetit te prokurimit dhe refuzimit te kërkesës për rishqyrtim nga ana e AQP-se. Ky aktivitet i prokurimit përfshin furnizimin me pajisje te ndryshme te TI-se për qeverinë qendrore dhe nivelin Lokal. AQP ka marr vendim për anulimin e aktivitetit te prokurimit ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se për arsye se dosja e tenderit dhe specifikimet teknike te përmbajtura ne te kane qene ne përputhje me nenin 28 te LPP-se dhe kane mundur te arrihen nga shumica e prodhuesve respektivisht ofertuesve ne treg. Ne periudhën para dorëzimit te ofertave ka pasur kërkesa për rishqyrtim dhe AQP ka modifikuar disa here dosjen duke marre kështu parasysh kërkesat për rritje te konkurrencës. Pas këse faze, nuk ka pasur ankesa shtese, gjë qe tregon se modifikimet e bëra kane plotësuar kushtin për inkluzivitet.

Rrjedhimisht, ne fazën para dorëzimit te ofertave, nuk ka pasur asnjë pretendim te OE për kërkesa diskriminuese. Qe dosja e tenderit ka qene ne përputhje me nenin 28 te LPP-se me se miri dëshmohet me faktin se kane qene se paku 5 operator ekonomik te cilët kane paraqitur ofertat e përgjegjshme për Lot 1 dhe/ose Lot 2 te aktivitetit te prokurimit. Prandaj, ne rastin konkret nuk ka pasur baze ligjore për konstatimin se specifikimet teknike janë ne kundërshtim me nenin 28 te LPP-se, kur 5 operator ekonomik kane qene ne gjendje te paraqesin ofertat te përgjegjshme. Një vendim i tille rrezikon ti diskriminoj këta 5 operator ekonomik te cilët kane paraqitur ofertat te përgjegjshme ne raport me Operatoret tjerë te papërgjegjshëm. Ne këtë mënyrë, Anulimi i Aktivitetit Tenderues paraqet veprim diskriminues ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se për Operatoret Ekonomik te përgjegjshëm. Pas vlerësimit te kësaj kërkesë ju lusim qe ta rishqyrtoni

vendimin tuaj dhe te vendosni ne mënyrë meritore, pa diskriminuar asnjë operator Ekonomik te përgjegjshëm"

Përgjigje e ekspertit shqyrtues

Bazuar ne Dosjen e Tenderit, Specifikimit teknik, ofertës se OE ankues, raportin e vlerësimit mund te konstatoj se:

AK ka vepruar ne kundërshtim me Ligjin e LPP-se kjo për faktin se:

1. Ka vepruar ne kundërshtim me vet raportin e vlerësimit, ku ne njërën ane e cilëson këtë OE si te përgjegjshme për faktin se ka plotësuar te gjitha kriteret teknike, mirëpo ne anën tjetër ketë procedura e anulon me arsyetimin se Specifikimi teknik është përgatitur ne kundërshtim me ligjin e LPP-se.

Konstatimin se AK - AQP ka vepruar ne kundërshtim me Ligjin e LPP-se e mbështes ne faktin se:

1. Nëse do te ishin specifikimet teknike ne kundërshtim me LPP dhe URROPP atëherë ky fakt do te duhej te evitohej gjate fazës se njoftimit për Kontrate dhe jo vetëm pasi te jene hapur ofertat.
2. Ne dokumentacionin përkatës nuk kam hasur ne ndonjë dokument i cili tregon te ketë patur Ankesa gjate fazës tenderuese për Specifikim teknik dhe për te njëjtën arsyet te jete anuluar ky aktivitet.
3. Sipas Raportit te vlerësimit përket procedure janë te suksesshëm
   a. LOT 1
      i. OE "InfosoftSystems"
      ii. OE "NOVUS"
      iii. OE "PBC"
      iv. OE " STORM ICT"
   b. LOT 2
      i. OE "Interadria"

2. Gjate analizimit te Ofertave te OE te cilët janë evidentuar si te suksesshëm për LOT 1 mund te konstatoj se ofertat e tyre kane Ofrues te ndryshëm si:
   i. OE "InfosoftSystems" ofron produkte te: "DELL", "Lenovo", "Acer"
   ii. OE "NOVUS" ofron produkte te: "Lenovo", "Acer,
   iii. OE "PBC" ofron produkte te:"HP", "Lenovo", "THinkcenter", Acer"
   iv. OE " STORM ICT" ofron produkte: "HP", "Lenovo", "Acer"

Gjë që shihet qarte se kemi te paktën 4 prodhues te ndryshëm te cilët plotësojnë kriteret teknike sipas Raportit te Komisionit, andaj mendoj se konstatimi i AK është ne kundërshtim me LPP pasi sipas ofertave dhe Raporti te Vlerësimit ekzistojnë 4 OE dhe te paktën katër prodhues te ndryshëm te cilët plotësojnë

kriteret e dosjes se tenderit.

Andaj në bazë të të gjitha shkresave për këtë lëndë konstatoj se AK ka vepruar ne kundërshtim me procedurat e LPP dhe URROP sipas njoftimit për kontrate, me çka rekomandoj qe ky aktivitet te kthehet ne Rivlerësim.

Përgjigje në pretendimin ankimore të OE ankues "NOVUS" shpk - Prishtinë

Pretendimi: "Kjo ankese paraqitet me respekt kundër vendimit për anulim te aktivitetit te prokurimit me titull " Furnizim me pajisje te TI-se, Ri-Tender" me numër te prokurimit UA/2016/18/3785-1-1-1 dhe numër te brendshëm AQP/18/001/11 Aktiviteti i prokurimit ka qene i ndare ne dy (2) Lote te cilat kane përfshirë furnizimin me pajisje te ndryshme te TI-se për nivelin qendror dhe nivelin lokal.

Autoriteti kontraktues AQP ka marre vendim për anulimin e Aktiviteti te prokurimit ne kundërshtim me nenin 62 paragrafi 1.1 te LPP-se, për arsye se dosja e tenderit dhe specifikimet teknike te përmbajtura ne te kane qene ne përputhje me nenin 28 te LPP-se dhe kane mundësuar te gjithë operator Ekonomik te paraqesin oferta te përgjegjshme. Fillimisht dhe pa se gjithash, ne përputhje me nenin 108 te LPP-se ekziston afati ligjor për paraqitjen e Ankesave ne lidhje me kërkesat dhe specifikat teknike, kjo ne periudhën para dorëzimit te ofertave. Ne këtë drejtim, ka pasur kërkesa për rishqyrtim dhe modifikime te kërkesave te dosjes se tenderit, te cilat kane bere te rritet konkurrenca. Si rrjedhoje, pas inkorporimit te ndryshimeve, nuk ka pasur asnjë ankese shtese për specifikat teknike.

Ne fazën para dorëzimit te ofertave, nuk ka pasur asnjë pretendim te OE-ve për këtë faze.

Përfundimisht, nuk mund te këtë dosje diskriminuese kur ne kuadër te dy lotëve ka pasur disa oferta te përgjegjshme te operatoreve te ndryshëm ekonomik. Fakti se dosja e tenderit ka qene ne përputhje me nenin 28 te LPP-se me se miri e dëshmohet me faktin se kane qene se paku 5 operator ekonomik te cilët kane paraqitur oferta te përgjegjshme për Lot 1 dhe/ose Lot 2 te Aktivitetit te Prokurimit. Prandaj, ne rastin konkret nuk ka pasur baze ligjore për konstatimin se specifikimet teknike janë ne kundërshtim me nenin 28 te LPP-se, kur 5 OE kane qene ne gjendje te paraqesin ofertat te përgjegjshëm. Një vendim i tille rrezikon ti diskriminoj këta 5 operator ekonomik te cilët kane paraqitur ofertat te përgjegjshme ne raport me operator tjerë te papërgjegjshëm. Ne këtë mënyrë, anulimi i aktivitetit tenderues paraqet veprim diskriminues ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se.

AK, me tutje ne vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si te pabazuar ka përdorur një arsyetim shabllon për te gjitha kërkesat për Rishqyrtim te paraqitura nga ana e OE te ndryshëm duke mos u përgjigjur ne pretendimet Specifike te operatoreve ekonomik specifik"

Përgjigje, bazuar ne Dosjen e Tenderit, Specifikimit teknik, ofertës se OE ankues, Raportin e vlerësimit mund te konstatoj se:

AK ka vepruar ne kundërshtim me Ligjin e LPP-se kjo për faktin se:

1. Ka vepruar ne kundërshtim me vet raportin e vlerësimit, ku ne njërën ane e cilëson këtë OE si te përgjegjshme për faktin se ka plotësuar te gjitha kriteret teknike, mirëpo ne anën tjetër ketë procedura e anulon me arsyetimin se Specifikimi teknik është përgatitur ne kundërshtim me ligjin e LPP-se.

Konstatimin se AK - AQP ka vepruar ne kundërshtim me Ligjin e LPP-se e mbështes ne faktin se:

1. Nëse do te ishin specifikimet teknike ne kundërshtim me LPP dhe URROPP atëherë ky fakt do te duhej te evitohej gjate fazës se njoftimit për Kontrate dhe jo vetëm pasi te jene hapur Ofertat.
2. Ne dokumentacionin përkatës nuk kam hasur ne ndonjë dokument i cili tregon te ketë paturp Ankesa gjate fazës tenderuese për Specifikim teknik dhe për te njëjtën arsyet te jete anuluar ky aktivitet.
3. Sipas Raportit te vlerësimit për ketë procedure janë te suksesshëm
   a. LOT 1
      i. OE "InfosoftSystems"
      ii. OE "NOVUS"
      iii. OE "PBC"
      iv. OE " STORM ICT"
   b. LOT 2
      i. OE "Interadria"

2. Gjate analizimit te Ofertave te OE te cilët janë evidentuar si te suksesshëm për LOT 1 mund te konstatoj se ofertat e tyre kane Ofrues te ndryshëm si:

   v. OE "InfosoftSystems" ofron produkte te: "DELL", "Lenovo", "Acer"
   vi. OE "NOVUS" ofron produkte te: "Lenovo", "Acer,
   vii. OE "PBC" ofron produkte te: "HP", "Lenovo", "THinkcenter", Acer"
   viii. OE " STORM ICT" ofron produkte: "HP", "Lenovo", "Acer"

Gjë që shihet qarte se kemi te paktën 4 prodhues te ndryshëm te cilët plotësojnë kriteret teknike sipas Raportit te Komisionit, andaj mendoj se konstatimi i AK është ne kundërshtim me LPP pasi sipas ofertave dhe raporti te vlerësimit ekzistojnë 4 OE dhe te paktën 4 Prodhues te ndryshëm te cilët plotësojnë kriteret e dosjes se tenderit.

Andaj në bazë të të gjitha shkresave për këtë lëndë konstatoj se AK ka vepruar ne kundërshtim me procedurat e LPP dhe URROP sipas njoftimit për Kontrate, me çka rekomandoj qe ky Aktivitet te kthehet ne Rivlerësim.

Përgjigje në pretendimin ankimore të OE ankues "PBC" shpk - Prishtinë

Pretendimi: "1. Konsiderojmë se AK ka shkelur paragrafin 3, 4, 5 te nenit 10 te ligjit nr 04/L-042 për prokurimin publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 Ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin NR. 05/L-092 sepse:

a. Nuk na është siguruar dokumentacioni për ne si pale e interesuar ne dokumentacionin e operatoreve te kualifikuar, respektivisht ne dokumentet qe kanë qene kriter i vlerësimit dhe përveç kësaj nuk është siguruar një kopje e tyre elektronike apo fizike, gjë qe përben shkelje dhe për një rast te ngjashëm – Vendimi 452/16 i OSHP-se

2. Konsiderojmë se AK ka shkelur nenin 7 te ligjit nr 04/L-042 për prokurimin publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 Ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin NR. 05/L-092 sepse::

a. AK nuk ka marr te gjitha masat e nevojshme për te parandaluar imponimin e rrethanave, qe kane shkaktuar diskriminim organizativ për ne si OE, duke tentuar te gjenden mekanizma ligjor qe te anulohet procedura, ku edhe pse sipas vendimit tuaj zyrtar ne e-prokurim te datës 05.06.2019 janë gjithsej katër konzorciume për LOT 1 qe janë cilësuar përgjegjshëm, AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit, gj qe përben shkelje te nenit 7 te LPP-se.

3. Konsiderojmë se AK ka shkelur nenet 28, 59 dhe 62 te ligjit nr 04/L-042 për prokurimin publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 Ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin NR. 05/L-092 sepse:

a. Gjate vlerësimit te ofertave dhe ne vendimin e paraqitur ne e-prokurim është potencuar citojmë: Agjencia Qendrore e Prokurimit anulon këtë aktivitet te prokurimit pas konstatimit se specifikimi teknik është ne kundërshtim me Ligjin nr 04/L-042 për prokurimin publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 Ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin NR. 05/L-092, nenet 28.2, 28.7 si dhe me RRUOPP nenet 20.3, 20.4 dhe 20.8 dhe si rezultat i kësaj është vendosur sipas Ligjit te Prokurimit Publik me nr. 04/L-042 nenit 62 paragrafi 1.1 qe te anulohet ky aktivitet.

Ky Anulim i procedurës ne fjale bie ndesh me LPP dhe RRUOPP-ne sepse specifikacioni teknik i paraqitur ne dosjen e tenderit nuk cenon asnjërin nga nenet e cekura te LPP-se (Neni 28) e as RUOPP-se (Neni 20). Rrjedhimisht, ne asnjë pjese te specifikimeve teknike nuk kemi gjetur referim te nje artikulli ose burimi te veçante ose ndonjë prodhimi. Ne anën tjetër, çështjet qe ndërlidhen me diskriminim do te duhej te konsumoheshin para dorëzimit te ofertave.

Po ashtu vlejnë te potencohet se ne vendimin mbi anulimin e AK-se, nëse lexohen arsyet e refuzimit/mos

refuzimit tek letra standarde për tenderuesit mund te shihet qarte se për LOT 1 janë kualifikuar si te përgjegjshme katër konzorciume, gjë qe tregon se faktin se specifikacioni teknik ka ofruar qasje te barabarte për tenderuesit dhe nuk ka pas krijuar ndonjë pengese për tu plotësuar.

Ne anën tjetër, nëse analizohen vendimi për njërin nga OE-te e cilësuar si e suksesshme për LOT 2 por ne mungese te 3 ofertave AK ka vendosur te anuloj ofertën, gjë qe ne shpërfaq diskriminimin nga OE-ve tjerë sepse po te ishin ne LOT 2 tre oferta (specifikacioni i LOT 1 dhe LOT 2) te përgjegjshme, atëherë për LOT 2 nuk është cilësuar qe përbehet ndonjë shkelje e LPP-se apo RRUOPP-se.

Prandaj, ne cilësojmë qe anulimi i këtij aktiviteti te prokurimit është bere pa u përmbushur arsyet e parashikuara ne nenin 62 te LPP-se.

Përgjigje, Bazuar ne Dosjen e Tenderit, Specifikimit teknik, Ofertës se OE Ankuese, Raportin e vlerësimit mund te konstatoj se:

AK ka vepruar ne kundërshtim me Ligjin e LPP-se kjo për faktin se:

3. Ka vepruar ne kundërshtim me vet Raportin e vlerësimit, ku ne njërën ane e cilëson këtë OE si te përgjegjshme për faktin se ka plotësuar te gjitha kriteret teknike, mirëpo ne anën tjetër ketë procedura e anulon me arsyetimin se Specifikimi teknik është përgatitur ne kundërshtim me ligjin e LPP-se.

Konstatimin se AK - AQP ka vepruar ne kundërshtim me Ligjin e LPP-se e mbështes ne faktin se:

4. Nëse do te ishin specifikimet teknike ne kundërshtim me LPP dhe URROPP atëherë ky fakt do te duhej te evitohej gjate fazës se njoftimit për Kontrate dhe jo vetëm pasi te jene hapur Ofertat.
5. Ne dokumentacionin përkatës nuk kam hasur ne ndonjë dokument i cili tregon te ketë paturp Ankesa gjate fazës tenderuese për Specifikim teknik dhe për te njëjtën arsyet te jete anuluar ky aktivitet.
6. Sipas Raportit te vlerësimit për ketë procedure janë te suksesshëm
   a. LOT 1
      i. OE "InfosoftSystems"
      ii. OE "NOVUS"
      iii. OE "PBC"
      iv. OE " STORM ICT"
   b. LOT 2
      i. OE "Interadria"

4. Gjate analizimit te Ofertave te OE te cilët janë evidentuar si te suksesshëm për LOT 1 mund te konstatoj se ofertat e tyre kane Ofrues te ndryshëm si:

   ix. OE "InfosoftSystems" ofron produkte te: "DELL", "Lenovo", "Acer"

x. OE "NOVUS" ofron produkte te: "Lenovo", "Acer,

xi. OE "PBC" ofron produkte te: "HP", "Lenovo", "THinkcenter", Acer"

xii. OE " STORM ICT" ofron produkte: "HP", "Lenovo", "Acer"

Gjë që shihet qarte se kemi te paktën 4 prodhues te ndryshëm te cilët plotësojnë kriteret teknike sipas Raportit te Komisionit, andaj mendoj se konstatimi i AK është ne kundërshtim me LPP pasi sipas ofertave dhe Raporti te Vlerësimit ekzistojnë 4 OE dhe te paktën 4 Prodhues te ndryshëm te cilët plotësojnë kriteret e dosjes se tenderit.

Andaj në bazë të të gjitha shkresave për këtë lëndë konstatoj se AK ka vepruar ne kundërshtim me procedurat e LPP dhe URROP sipas njoftimit për Kontrate, me çka rekomandoj qe ky Aktivitet te kthehet ne Rivlerësim.

Përgjigje në pretendimin ankimore të OE ankues "BOTEK" shpk - Prishtinë

Pretendimi 1: "Gjate procedurës së sqarimeve shtesë ne fazën e tenderimit, përveç kompanisë tone edhe shumë OE dhe prodhues të tjerë me fakte e kanë konstatuar se Specifikimi Teknik në ketë dosje të tenderit kane qenë dhe janë përgatitur qartësisht dhe njëanshëm vetëm duke u bazua në një prodhues të vetëm Lenovo.

Përgjigje: Konsideroj se nëse do te kishte vërejtjet te tilla ankesat do te duhet te bëheshin gjate fazës se njoftimit për kontrate dhe jo vetëm tani pas hapjes se ofertave.

Pretendimi 2: "Fakti i pamohueshëm s'e disa OE gjegjësisht grupe të OE në këtë procedurë të prokurimit kane qene të organizuara— (Grupi "Novus" shpk dhe "Cacttus" sha", Grupi "Storm ICT & StormComputerdoo" dhe Grupi "PBC shpk & SoftëareDevelopmentSolution dhe Gis Data") te cilët ne ketë aktivitet te prokurimit kane ofertuar me DAF (Autorizim nga Distributori i te njëjtës kompani ITD, dhe me produkte të prodhuesit te njëjte Lenovo. Bazuar në ketë fakt këto grupe te OE fare nuk kane pasur nevojë për sqarime shtese ne fazën e tenderimit, pasi qe produktet e tyre me te cilat kane ofertuar i kane përmbushur 100% të gjitha specifikimet teknike dhe rrjedhimisht edhe janë të përgjegjshme teknikisht. Ky fakt e bazon fuqizon dyshimin e bazuar se AK paraprakisht i ka përshtatur specifikat teknike për prodhuesin Lenovo.

Fakt tjetër se këta OE janë organizuar për te eliminuar ne mënyrë kundërligjshme OE dhe prodhues tjerë, është edhe fakti se pesë vendimit kualifikim nga ana e AK-se me date 15.01.2019 qe te tri grupet e OE kane deponuar Kërkesë për Rishqyrtim për këtë procedure.

Ankesat e tyre i kane bazuar jo ne eliminimin e tyre, sepse qe te tri grupet kane qene te kualifikuara, por ata janë ankuar ne dy OE tjerë te kualifikuar, Grupi "Ilir Kosova &Comtrade Computers" dhe kompaninë tone

BOTEK, te cilat kane ofertuar me produkte te prodhuesve tjerë, (DELL, Fujitesu Simens) dhe te cilit do te kishin hapur konkurrencën te mirëfilltë ne procedurën e mini-tenderimit.

Me eliminimin e Grupeve te OE te cilët kane ofertuar me produkte te prodhueseve tjerë po eliminohet konkurrenca tërësisht dhe po mundësohet një distributori (ITD) dhe një prodhuesi te vetëm (LENOVO) qe ne fazat e mini konkurrencës te kontrollojnë ne tërësi tregun dhe ti mundësohen këtyre tri grupeve te OE qe te bëjnë marrëveshje te fshehta- ne stilin e kartelave te organizuara kriminale."

Përgjigje: Gjate analizimit te Ofertave te OE te cilët janë evidentuar si te suksesshëm për LOT I mund te konstatoj se ofertat e tyre kane Ofrues te ndryshëm si:

i. OE "InfosoftSystems" ofron produkte te: "DELL", "Lenovo", "Acer"
ii. OE "NOVUS" ofron produkte te: "Lenovo", "Acer,
iii. OE "PBC" ofron produkte te: "HP", "Lenovo", "THinkcenter", Acer"
iv. OE " STORM ICT" ofron produkte: "HP", "Lenovo", "Acer"

Dhe jo vetëm LENOVO

Pretendimi 3: "1. 'Tek Modeli III i shtëpizës është kërkuar tek memoria; 16 GB UDIMM, DDR4-2400 me kapacitet maksimal deri ne 64 GB ndërsa ju keni ofruar; 8 GB memorie".

SQARIM: Ky lëshim teknik nga ana jonë ku është dashur normalisht te jete 2 X 8 GB UDİMM-2400 është harruar te shënohet 2X dhe rrjedhimisht është krijuar nevoja që ju si AK te sqaroni me OE ashtu sikurse e parasheh edhe LPP pasi që lëshime të tilla teknike nuk përbejnë arsye për të eliminua një OE nga konkurrenca. Tutje ne Broshurën e dorëzuar se bashku me tenderin për ketë model të PC-s shihet qartë se ky Model I PC I përkrah RAM memorie deri 64 GB ."

Përgjigje: Bazuar ne Dosjen e tenderit përkatësisht kërkesës për memorie:16 GB UDIMM, DDR4-2400, Ju si OE ne dosjen e dorëzuar keni ofertuar me pajisje me kapacitet 8 GB UDIMM, DDR4-2400ne vend te qe te ofertoni me16 GB UDIMM, DDR4-2400, fakt te cilin e potenconi edhe ju.

Dua te ua rikujtoj Ankesën e juaj te datës: 06.04.2018 ndaj AK-RTK për të njëjtin pretendim Ankimor, citat nga ankesa e OE BOTEK kundër AK - RTK:

"Ne dosjen e tenderit te pozicioni 2 kërkohet "6 x 4TB 7.2K RPM 12Gbps 512n 3.5in Hot-plug HardDrive (onPCIeRaid)" Prova 1, faqe 3Operatori i cili është propozuar për kontrate ka ofruar server me 6 x 2TB qe nuk i plotëson kërkesat"

Vendimi i datës 06.06.2018 me numër 200/18 i cili vërteton Ankesën e OE BOTEK.

Konsideroj se Ky pretendim Ankimor është i pa bazuar pasi një ndryshim i tille përbën ndryshim Kapital.

Pretendimi 4: "2. "Tek Modeli i IV Ali-ın- one, është kërkuar Full HD 1080p (1920X1080) TFT Color, withWidevievingangle (+7-89 0) LED backlight, 250 nits...ndërsa produkti juaj Nuk është TFT Color dhe

LED backliqh".

SQARIM: Edhe ky specifikim teknik është pikërisht i precizuar si i tillë duke u mbështet në një produkt të vetëm te prodhuesit Lenovo dhe përshkrimet te tilla te detajeve teknike fare te parëndësishme edhe mundem mos me qenë te evidentuara ne broshurat e prodhuesve te tjerë pasi që jo te gjithë prodhuesit i përshkruajnë specifikimet teknike me emërtime te njëjta dhe njësoj.

Sidoqoftë, konstatimi i komisionit vlerësues tuajin, në ketë rast NUK është i qëndrueshmen pasi që produkti DELL i ofruar nga ne posedon ekran i cili ka ndriçimin LED dhe është Color. Përveç tjerash, është absurde te mendohet se ndonjë prodhues i PC - All In One, prodhon kësi Lloj PC me Ekran monochrome (bardh e zi) dhe jo Color / me ngjyra.

Ne këtë link shihen qarte ne detaje specifikat e ekranit te OptiPlex 5260 ku edhe përshkruhet se është WLED dhe përkrahë deri ne 16.7milion ngjyra. https://lwww.dell.com/support/manuals/us/en/04/optiplex-5260-aio/optiplex_5260_setup_specs/display?guid=guid-3ca1b54c-f0b1-4985-8501-e216f53bfeb3&lang=en-us

Përgjigje:

Pretendimi 5:3. "Lexuesi Optik është kërkuar DVD driver pra DVD RË — Ofrohet vetëm nëpërmjet HIGHT ADJUSTABLE STAND".

SQARIM;

Ne ofertën tone ne kemi përshkruar se ky model i PC ofertohet me "Lexuesi optik: DVD RË Drive", dhe po ashtu OptiPlex 5260 përkrahë DVDRË.

Lloji i stand nuk ka qene kërkesë ne specifikime teknike, dhe ne nuk kemi pa nevojën qe t'a përshkruajmë ne oferte sidomos kur dihet se nëse ofertojmë DVDRË, siç edhe kemi ofertuar, çfarë stand do te duhej te ketë AIO. Produkti jone e plotëson këtë kërkesë ku mund te vërtetohen edhe në broshure edhe në ofertën e dorëzuar. Ky konstatim i komisionit vlerësues është tendencioz dhe 100% është i bazuar apo influencuar direkt nga ankesa e kaluar e Operatoreve Ekonomik "Novus" Shpk dhe "Cacttus"Sha.

"Camera NUK eshtë LED indicator dhe nuk ka opcioninphysicalsëitschon / off "

SQARIM: Edhe ky konstatim i komisionit vlerësues e qartëson saktë tendencën që të nxjerrë të gjithë prodhuesit e tjerë nga konkurrenca dhe të favorizon një prodhues të vetëm Lenovo dhe disa OE të caktuar. Sidoqoftë, pavarësisht faktit, Produkti i ofertuar nga ne i prodhuesit Dell 100% e plotëson këtë kërkesë. Ashtu siç është përshkruar ne oferte posedon Full HD pop-up camera e cila edhe ka opsionin LED dhe po ashtu është mekanike dhe ne mënyrë fizike mbyllet (fshihet brenda kornizës se AIO) dhe hapet. Për me detaje mund te gjeni edhe vizatimin/specifikat ne linkun me poshtë nga prodhuesi Dell https://www.dell.com/support/manuals/us/en/04/optiplex-5260-aio/optiplex_5260_setup_specs/pop-up-camera-optional?guid=guid-85178857-ca3a4479-8cc1-fc0024ff2ead&lang=en-us

Përgjigje:

Pretendimi 6: "5. " tek Modelet e Laptopeve tek portet shtesë, ju keni ofruar produkt 3 X USB 3.1 Gen 1 (oneWithpowerschare) Display Port over USB Type C... Type C nuk është port Standard, nuk i plotëson kërkese "e dosjes".

SQARIM: Edhe ky detaj i specifikimit teknik flet qartë sa sa i njëanshëm është përshkruar dosja e tenderit duke u bazua vetëm tek prodhuesi Lenovo dhe po ashtu edhe ne këtë pike komisioni vlerësues është është i bazuar apo influencuar direkt nga ankesa e kaluar e Operatoreve Ekonomik "Novus" Shpk dhe Cacttus"Sha. Sidoqoftë ky konstatim i AK se USB Type C nuk është port standard është i paqëndrueshëm sepse standardet e sikurse te USB 2.0, 3.1 spoTypec i cakton USB Implementers Forum https://www.usb.org/ dhe te cilat adoptohen nga IEC - InternationalElectrotechnicalCommission.

Produkti i ofruar nga ne qe NUK i përmbush kërkesën minimale është i paqëndrueshëm për faktin se; Produkti i Ofertuar nga ne i prodhuesit DELL me ane te USB Type i tejkalon kërkesat se përveç se e përkrahë USB 3.1 ky port po ashtu përkrahë edhe Display Port dhe PowerDelivery.

Për me shume ne këtë link mund te gjeni përparësitë e USB Type-C:

https://www.dell.com/support/_article/us/_en/04/sln296827/displayport-over-usb-type-c?lang=en

AdvantagesofDisplayPorttMover USB Type-C

FullDisplayPort audio/video (A/V) performance (up to 8K at 60Hz).

SuperSpeed USB (USB 3.1) data transfer.

Up to 100 wattsofpoëerover a singlecab/e.

Reversible plug orientationandcabledirection.

Backwardscompatibility to VGA, DVI withcompatibleadapters.

Supports HDMI 2.0a onselectproductsandisbackëardscompatiblewithpreviousversions.

Pretendimi 7:6. 'Tek Projektorët, DigitalInputs: produkti i ofruar nga ana juaj ka portin USB, mirëpo nuk e ka portin mini-USB siç është kërkuar ne dosje gjithashtu modeli i ofruar ka image size nga 58cm deri ne 762cm. Nuk plotëson kërkesën ne dosje ku është kërkuar Min. 68 cm — 762 cm or better"".

SQARIM: Meqenëse ne baze te LPP-se lejohet te ofertohen produkte me specifika ekuivalente, ky konstatim i AK-se është i pa bazuar sepse:

a) USB port i ofertuar nga ne është 100% ekuivalent me mini-USB, për vete faktin se ne te dy rastet jemi duke diskutuar për te njëjtin standard te ndërlidhjes, pra USB. Shpejtësia/performasna e qe te dyjave është e njëjta.

b) Imagesize i ofruar nga ne plotëson dhe tejkalon kërkesën ne dosjen e tenderit. 58cm deri 762cm përfshinë spektër edhe me te gjere te Imagesize (madhësisë se fotografisë). Pra madhësia e fotografisë mund te

rregullohet nga 58cm deri 762cm, ku mund te jete 58cm edhe 59cm, 60cm, 61cm, 62cm, 63cm, 64cm, 65cm, 66cm, 67cm, 68cm etj, deri ne 762cm, ndërsa ne dosje është kërkuar nga 68cm deri 762cm.

Përgjigje, bazuar ne dosjen e tenderit, specifikimit teknik, ofertës se OE ankues, raportin e vlerësimit mund te konstatoj se:

Andaj, në bazë të të gjitha shkresave për këtë lëndë konstatoj se AK ka vepruar ne kundërshtim me procedurat e LPP dhe URROP sipas njoftimit për kontrate, me çka rekomandoj qe ky aktivitet te kthehet ne Rivlerësim.

Mendimi i ekspertit teknik

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne Rivlerësim.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 09.07.2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se nuk pajtohet më raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Botek shpk" përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se ***nuk pajtohet*** më raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "PBC" përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se ***pajtohet*** më raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Novus" shpk përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se ***pajtohet*** më raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.07.2019 ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, eksperti shqyrtues-teknik, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, nga operatoret ekonomik ishte prezent vetëm OE-"PBC" kurse operatoret tjerë edhe pse ishin ftuar në mënyre te rregullt nga ana e OSHP-së, për arsyeje te pa qarta nuk ishin prezent në seancë, seanca vazhdoj me prani te palëve prezente ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për anulim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues "PBC" z. Pallaska deklaroj: "Siç është paralajmëruar ne email se OE Botek ka pranuar pas pranimit te ekspertizës OE Botek e pranon pjesën e

ekspertizës pjesën qe ka te bej me ankesën e vet, ndërsa konstatimet e ekspertizës për OE te tjerë qe janë pjesëmarrës ne këtë procedurë i kundërshton ne tërësi për faktet si ne vijim: ne piken 9.1 te FTD-se nga te gjithë OE është kërkuar qe me rastin e dorëzimit te tyre te dorëzojnë edhe formularët e autorizimit te produktit përkatës DAF,. Me këtë rast te gjithë OE përveç Botekut kanë dorëzuar DAF nga një subjekt i vetëm juridik përkatësisht OE ITD PRISHTINE SH.P.K. këta DAF nuk kanë qen te shoqëruar me asnjë dokument qe ka vërtetuar qe ky OE është i autorizuar te distribuoj për produkte te tilla për HP EASER edhe Lenovodhe aq me pak ky OE mund te lëshoj autorizime për OE te tjerë. Ky fakt është vejtur nga komisioni vlerësues nga Autoriteti Kontraktues i cili me shkresa te veçanta i është drejtuar te gjithë OE-ve përveç Botekut qe te sqarojnë dhe te konfirmojnë validitetin e DAF-it te lëshuar nga OE ITD Prishtine SH.P.K. ne vend se te adresojnë kërkesën eksplicite te Autoriteti Kontraktues te gjithë OE përveç OE Botek kanë dorëzuar DAF qe prodhuesit e lartpërmendur i ka lëshuar DAF subjektit juridik ITD Prishtine edhe pse ndërlidhjet me te parin me seli ne Tirane Shqipëri. Ne këtë mënyrë këto subjekte kanë vërtetuar se DAFI i dorëzuar me paraqitjen e Ofertës ishte tërësisht jo valid, i vetmi përjashtim ishte DAFI i lëshuar nga Prodhuesi Lenovo i cili qartësonte se ITD Prishtine SH.P.K. ka te drejtë te lëshoj autorizime te tilla ne këtë mënyrë subjektet e larte përmendura kanë dështuar te përmbushin kërkesën e pikës 9.1 te FDT-së ne kuptim te nenit 59 te LPP-së, pa paragjykuar arsyet tjera vetëm mbi këtë bazë këto ofertat e dorëzuara subjekte duhen te konsiderohen te papërgjegjshme. Pa paragjykuar argumentet e cekura me lart është me rendësi te nënvizohet se te gjitha subjektet pjesëmarrëse ne këtë AP përveç Botek janë te ndërlidhura ne qofte ne kuptim te kontrollit efektiv mbi to nga subjekte te caktuara qofte me kontrollin qe subjektet kanë mbi subjektet konkurruese kanë mbi burimet e furnizimit.

Rrjedhimisht te gjitha këto subjekte konkurruese ndërlidhja e tyre qe me asgjë tjetër vërtetohet me faktin qe te gjitha konkurrojnë me një DAF te vetëm edhe pse jo valid e komprometon ne tërësi konkurrencën qe pretendohet qe do te zhvillohet ndërmjet këtyre subjekteve po procedura e prokurimit vazhdon ashtu siç është planifikuar nga Autoriteti Kontraktues. Kjo është edhe një arsye qe ankesa e këtyre subjekteve te refuzohen ne kuptim te përgjithëshmërinë ne këtë AP.

Për te ju kthyer ofertës se OE Botek është me rendësi qe eksperti ka vlerësuar qe te gjitha arsyet për shpallës se kësaj oferte te papërgjegjshme nuk qëndrojnë, ndërsa e vetmja pike qe nuk është prekur ne ekspertize është pika për kapacitetin e Memories Ram ne njërin produktet (DEL OPTI PLEX 3060) e cila duket qe është konsideruar qe është lëshim teknik ne deklaratën për përmbushjen e kushteve specifike nga eksperti teknik ne deklaratën e përmbushjes se kushteve teknike për shkak se katalogu i këtij produkti qe ka qen pjese përbërës e ofertës përcakton qartësisht se Produkti i ofruar e mbështet zgjidhjen teknike te kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, sidomos ne dritën e faktit se produkti identik është certifikuar pranuar nga Autoriteti Kontraktues dhe rrjedhimisht eksperti ne ofertën e OE Infosoft Systems. Panelit shqyrtues ia dorëzon faktet për pretendimet ankimore.

